

KLASAT E BASHKANGJITURA NË KOMUNËN E PRISHTINËS

TringaAzizi1 SamireBllaca2 Shpresa Zaplluzha3 Dritan Ceka4

1-University European of Tirana, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd.70, H.1, Njesia
Bashkiake Nr.7, Kodi Postar 1023, Tirane, Albania, E-mail: tringa.azizi@hotmail.com

2-University European of Tirana, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd.70, H.1, Njesia
Bashkiake Nr.7, Kodi Postar 1023, Tirane, Albania

3-University European of Tirana, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd.70, H.1, Njesia
Bashkiake Nr.7, Kodi Postar 1023, Tirane, Albania

4-University European of Tirana, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd.70, H.1, Njesia
Bashkiake Nr.7, Kodi Postar 1023, Tirane, Albania

Abstract

This study aims to assess the functioning of attached classes, and treatment of students with special needs. Inclusive classes function as special classes within regular schools. Here, we teach students with different impairments, but who have contact also with other students. This is a good way to integrate children with special needs in the regular education system. How does the inclusive classes function it is shown within the research, where 4 that have inclusive classes schools were this research there are included 4 schools, which under their shield also have inclusive classes. Method of theoretical analysis, method of focused group, observation method, and statistical comparison have been used. Monitoring protocol, the focus group instrument, and supporting tools, such as Dictaphone, serving for storage and transcription of the conversation are also used.

Based on the results, we see that the teacher adapted almost all activities to the needs of students, at the level of 4.75 points; communication is at the level of 3.75 points. As per the results, we were able to calculate the arithmetical middle, which is: $\bar{x}=4$. In attached classes teacher plays an important role, treating properly students with special needs and this affects students and other school staff for a deserved treatment of students with special needs. Recommendations: Teachers should find appropriate ways to reach out children with special needs, whereas Faculty of Education must pay more attention to the classes dealing with the education of children with special needs. MEST has to invest even further in the training of teachers, in the field of special education, and Municipal Departments of Education has to engage trained teachers in attached classes.

Key words: *Student, Special needs, Attached classes, Regular school, Individual Plan.*

1. Hyrje

Klasat e bashkangjitura në komunën e Prishtinës, por edhe në Kosovë kanë gjetur zbatim pas vitit 2000, dhe janë të rëndësishme për integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta në sistemin e rregullt arsimor.

Me anë të një studimi empirik mund të vërtetohet se sa janë funksionale klasat e bashkangjitura në komunën e Prishtinës.

Ndryshimet e mëdha shkencore, shoqërore e humane kanë ndikuar që pozita e nxënësit me nevoja të veçanta të ndryshojë “nga një qenie e pavlerë”, në një nxënës të barabartë me të tjerët. Fëmijët me nevoja të veçanta edukoheshin dhe edukohen nëpër ente speciale (që ekzistojnë edhe në vendin tonë), mirëpo tendencat e disa ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar janë që fëmijët me nevoja të veçanta të integrohen nëpër shkolla të rregullta.

Nëpër disa shkolla fillore ekzistojnë nxënës me nevoja të veçanta që ndjekin procesin mësimor në klasa të rregullta, ndërsa në disa shkolla të tjera ekzistojnë klasa të veçanta ku edukohen dhe arsimohen këta fëmijë. E tërë kjo përpjekje bëhet me qëllim të integritit të fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin e rregullt. Kuptohet kjo bëhet me një përkushtim të madh të ekspertëve, me përshtatje të programeve individuale, objekteve e mjeteve për këta fëmijë.

Shoqëria jonë duhet çdo herë të bëjë përpjekje që fëmijët me nevoja të veçanta të kenë mundësi të edukohen e arsimohen.

Ky studim ka synim që të përcaktoj:

1. Funksionimin e klasave të bashkangjitura;
2. Trajtimin e nxënësve me nevoja të veçanta.

2. Klasat e bashkangjitura

Me qëllim të përfshirjes së një numri më të madh të fëmijëve me nevoja të veçanta, të racionalizimit financiar dhe të zvogëlimit të stafit administrativ në shkollat fillore, ka filluar integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla të rregullta. Për këtë qëllim ka filluar hapja e klasave speciale në kuadër të shkollave të rregullta nëpër të gjitha komunat e Kosovës. Këto janë klasa të kombinuara. Paralelet e kombinuara përbëhen nga dy e më tepër klasa. Një paralele mund t'i ketë dy ose tri klasa në një mësonjëtoje me të cilat përnjëherë, mund të punojë një mësues. Kombinimi i klasave mund të jetë i ndryshëm dhe varet nga numri i nxënësve. Kombinimi mund të jetë: I-II-III apo II-III-IV. Paralelet që përbëhen prej dy klasave kanë po ashtu kombinime të ndryshme.

Klasat e bashkangjitura funksionojnë si klasa speciale brenda shkollës së rregullt. Në këto klasa mësojnë nxënës me dëmtime të ndryshme, por që kanë kontakt edhe me nxënësit e tjerë të shkollës. Kjo është një e mirë drejt integritit të fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin e rregullt dhe me fëmijët e tjerë.

Në klasat e bashkangjitura mësim jep mësuesi special, por që ndihmohet nga mësuesi përkrahës.

Edukimi dhe arsimimi i nxënësve me nevoja të veçanta në klasat e bashkangjitura ndikon pozitivisht në socializmin dhe edukimin e drejtë të tyre, si dhe eliminimin e paragjykimëve ndër nxënësit e klasave të rregullta.

Nëse klasat e bashkangjitura formohen drejtë, nxënësve me nevoja të veçanta u krijohet një ambient i favorshëm, kështu që gjasat janë shumë të mëdha që këta nxënës të arrijnë rezultate të mira në bazë të mundësive individuale.

Klasat e bashkangjitura janë një hap pozitiv drejt gjithëpërfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në sistemin e rregullt arsimor.

3. Metodologjia e hulumtimit

3.1 Qëllimi i hulumtimit

Projekti për studimin e “Klasat e bashkangjitura në komunën e Prishtinës” ka për qëllim vlerësimin e funksionimit të klasave të bashkangjitura në komunën e Prishtinës.

Zgjidhja e disa dilemave të cilat janë manifestuar në këtë lëmë është qëllimi themelor i hulumtimit, ndër të cilat veçojmë:

- Trajtimi i nxënësve me nevoja të veçanta nga ana e mësuesit dhe nxënësve të tjerë
- Funksionim i klasave të bashkangjitura.

3.2. Instrumenti i hulumtimit

Instrumenti i studimit ishte një instrument për vëzhgim në klasat e bashkangjitura, i cili përbëhet prej 3 pjesëve.

Në pjesën e parë u përfshinë karakteristikat demografike të mësuesve dhe nxënësve.

Në pjesën e dytë, janë përfshirë pika që kanë të bëjnë me faktorët që lidhen me klasat e bashkangjitura.

Në Pjesën e tretë janë përfshirë udhëzimet lidhur me aktivitetet në klasat e bashkangjitura.

Përmbajtja e protokollit për vëzhgim:

- Mësuesi zhvillon aktivitetet në përshtatje të mundësive të nxënësve
- Komunikimi brenda klasës së bashkangjitur
- Përmbajtjet mësimore që u ofrohen nxënësve
- Organizimi i klasë
- Ndihma e mësimitdhënësit dhënë nxënësve
- Respektimi i të drejtave të nxënësve me nevoja të veçanta

Përmbajtja e udhëzimeve në klasë:

- Aktivitetet me grupe të veçanta të nxënësve
- Aplikimi i metodave e teknikave ndërvepruese
- Aktivitetet me individë të veçantë
- Angazhimi i nxënësve në udhëheqje të ndonjë aktiviteti

- Ndhurma e dhënë grupeve të nxënësve në zgjidhjen e problemeve
- Ndhurma e dhënë individëve në zgjidhjen e problemeve
- Të tjera.

3.3. Popullacioni i hulumtimit

Për ta zbardhur shumanshëm, pra edhe nga aspekti empirik këtë temë, për përfshirje në hulumtim, popullacionin themelor e paraqitnin të gjitha klasat e bashkangjitura në komunën e Prishtinës.

Meqë popullacioni i kësaj problematike është i vogël, në hulumtimin e kemi bërë drejtpërdrejtë në popullacionin e vet.

Popullacioni përbëhet nga 7 klasë të bashkangjitura në katër shkollave të Prishtinës.

3.4. Metodat e hulumtimit

Gjatë këtis tudimi, janë aplikuar këto metoda të hulumtimit:

- Metoda e analizës teorike
- Metoda e të vëzhgimit
- Metoda historike
- Metoda krahasuese
- Metoda statistikore.


4. Interpretimi i rezultateve

Në kuadër të hulumtimit për edukimin dhe arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta, janë përfshirë disa klasa të bashkangjitura në shkollat e rregullta.

Në kuadër të këtyre shkollave edukohen fëmijë me nevoja të veçanta me lloje të ndryshme të dëmtimeve: me dëmtime në të dëgjuar, me dëmtime fizike, me ngecje mendore, me probleme në sjellje, me autizëm etj.

Hulumtimi është organizuar në shtatë klasë të katër shkollave të Prishtinës.

Grafikoni nr. 11: Protokoli i vëzhgimit për popullacionin



Në këtë grafikun me shtylla janë paraqitur rezultatet e vëzhgimit për tërë mostrën.


1. Aktivitete në përshtatje të mundësive të nxënësve - Në këtë çështje, mësimitdhënësit e klasave të bashkangjitura e kanë nivelin e 4.75 pikëve, që do të thotë se ,pothuajse të gjitha aktivitetet ua përshtatin secilit nxënës në varësi të nevojave të tyre.
Komunikimi brenda klasës së bashkangjitur- Në këtë çështje, del se mësimitdhënësit qëndrojnë tek niveli i 3.75 pikëve, që do të thotë se, mësimitdhënësit komunikojnë pothuajse, me të gjithë nxënësit, pavarësisht dëmtimeve të tyre (nëse jo vet, ka ndihmës që mund të komunikojë me nxënësit).
2. Përbajtja mësimore që u ofrohet nxënësve - Në këtë çështje niveli i pikëve është 4.5, që do të thotë se mësimitdhënësit pothuajse, në të gjitha rastet kanë një program individual për secilin nxënës (përbajtjet mësimore e edukative mësimitdhënësi ua përshtat secilit nxënës në varësi prej dëmtimit).
3. Organizimi në klasë - Në këtë çështje niveli i pikëve është 2.75, që do të thotë se nxënësit janë të ulur pothuajse, pa ndonjë kriter të caktuar.
4. Ndihma e mësimitdhënësit dhënë nxënësve - Mësimitdhënësit punojnë pothuajse, me secilin nxënës veç e veç, për t'u ndihmuar në zgjidhjen e problemeve dhe me këtë rast niveli i pikëve është 4.75.
5. Respektimi i të drejtave të nxënësve me nevoja të veçanta - Mësimitdhënësit i respektojnë të gjithë nxënësit pa dallim të dëmtimeve të tyre dhe i motivojnë për punë mësimore. Në bazë të kësaj është arritur niveli prej 3.6 pikëve.
6. Klima në shkollë - Niveli i pikëve për këtë çështje është 3.9, që do të thotë se, nxënësit me nevoja të veçanta trajtohen mirë nga të tjerët në shkollë (mësimitdhënësit, nxënësit dhe të tjerët).

Në kuadër të rezultateve, e kemi nxjerrë edhe mesin aritmetik për popullacionin e që është: $\bar{T}=4$.

Duke u bazuar në pikët maksimale në këtë vëzhgim, që janë 4.6, mund të konstatojmë se mesi aritmetik i çështjeve që i kemi hulumtuar qëndron në nivel të kënaqshëm. Me këtë

rezultat të mesit aritmetik mund të konstatohet se, mësimeve zhvillojnë aktivitete në përshtatshmëri me aftësitë e nxënësve me nevoja të veçanta, i respektojnë të drejtat e tyre dhe ekziston një klimë e përshtatshme për edukimin dhe arsimin e nxënësve me nevoja të veçanta në klasat e bashkangjitura.

Grafikoni nr. 12: Udhëzimet në klasë për popullacionin



Për të vërtetuar se në çfarë mase përdoret një aktivitet në klasë brenda një ore mësimore, e kemi matur me minuta, e minutat i kemi shndërruar në përqindje.

Brenda orës kemi vëzhguar këto aktivitete:

1. Aktivitetet me grupe të veçanta të nxënësve - Mësimeve e klasave të bashkangjitura 12.5 % të kohës e shfrytëzojnë për këtë aktivitet.
2. Aplikimi i metodave e teknikave ndërvepruese - Mësimeve i kushtojnë 15.6 % të kohës këtij aktiviteti.
3. Aktivitetet me individ të veçantë - Aktiviteteve me individ të veçantë, mësimeve ua kushtojnë 22 % të kohës së përgjithshme të një ore mësimore.
4. Angazhimi i nxënësve në udhëheqje të ndonjë aktiviteti - Për këtë aktivitet mësimeve e klasave të bashkangjitura kanë ndarë 3 % të kohës së përgjithshme të një ore mësimore.
5. Ndihma e dhënë grupeve të nxënësve në zgjidhjen e problemeve - Mësimeve e klasave të bashkangjitura rreth 15.6 % të kohës e shfrytëzojnë duke u ndihmuar grupeve të ndryshme të nxënësve në zgjidhjen e problemeve.
6. Ndihma e dhënë individëve në zgjidhjen e problemeve - Rreth 25 % të kohës së një ore mësimore, mësimeve e klasave të bashkangjitura e shfrytëzojnë për dhënien e ndihmës individëve në zgjidhjen e problemeve mësimore.
7. Të tjera - Për këtë aktivitet mësimeve e klasave të bashkangjitura e shfrytëzojnë 6.3 % të kohës së përgjithshme të një ore mësimore.

5. Përfundime

Me anë të një hulumtimi të organizuar mirë, është arritur një nivel i njohurive se në çfarë niveli qëndrojnë klasat e bashkangjitura dhe me këtë rast është konstatuar se mbështeten hipotezat e parashtruar para se të organizohet hulumtimi. Nëse e shikojmë edhe rezultatin e mesit aritmetik për komplet popullacinë, mund ta kuptojmë se mesit aritmetik gjendet shumë afër pikëve maksimale.

Nga të gjitha çështjet që janë hulumtuar, rezulton se klasat e bashkangjitura janë në një nivel mjaftë të kënaqshëm.

1. Në bazë të rezultateve është kuptuar se, në përgjithësi mësuesit të gjitha aktivitetet ua përshtatin nevojave të nxënësve .
2. Mësuesit e klasave të bashkangjitura komunikojnë gati me të gjithë nxënësit, pavarësisht dëmtimeve të tyre.
3. Të gjithë mësuesit ,pothuajse kanë një plan individual për secilin nxënë.
4. Në përgjithësi të gjithë nxënësit janë të ulur në klasë pa ndonjë kriter të caktuar dhe janë të ulur përballë mësuesit.
5. Të gjithë mësuesit punojnë, pothuajse me secilin nxënë veç e veç, për t'u ndihmuar në zgjidhjen e problemeve.
6. Konsiderojmë se të drejtat e nxënësve me nevoja të veçanta respektohen shumë klasat e bashkangjitura.
7. Klima në shkollën ku ka klasë të bashkangjitura është mjaft e favorshme për fëmijët me nevoja të veçanta.

Duke u bazuar në këto të dhëna, konsiderojmë se klasat e bashkangjitura ndikojnë mjaft mirë në integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin e rregullt mësimor.

6. Rekomandime

Në vijim kemi dhënë disa rekomandime:

- a. Rekomandime për mësimdhënësit
 - Mësimdhënësit të gjejnë mënyra për qasje të duhur ndaj nxënësve me nevoja të veçanta dhe t'i trajtojnë ata si nxënës që mund t'ia dalin.
 - Mësimdhënësit e papërvojë t'i shfrytëzojnë edhe përvojat e të tjerëve për edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta.
- b. Rekomandime për Fakultetin e Edukimit dhe të Pedagogjisë
 - Në kuadër të lëndëve pedagogjike, t'i lejohet hapësirë më e madhe lëndës Pedagogji speciale dhe t'u mundësohet studentëve një zgjerim i njohurive lidhur me edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin e rregullt arsimor.
 - Të përgatiten studentët edhe në aspektin praktik për punë në klasë të bashkangjitura.
- c. Rekomandime për MASHT-in
 - Të vazhdohet me trajnimet e mësimdhënësve për punë në klasë të bashkangjitura.
 - Të krijohen kushte për integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin e rregullt mësimor.
- d. Rekomandime për DKA-të
 - Mësimdhënësit e trajnuar të angazhohen në klasat e bashkangjitura. Të përmirësojnë kushtet për punë mësimore në klasat e bashkangjitura. Në klasat e bashkangjitura mos të ketë numër të madh të nxënësve.

7. Literatura

- “Aftësitë për jetë”, libër për mësues (2007), MASHT, Prishtinë.
- Ajduković, Dean (red) 2001, “Forcimi i fëmijëve, Ndihma psikosociale në rrethana të vështira jetësore”, SHNP, Zagreb.
- Aliu, F. “Politika e edukimit special në Kosovë” (2002), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shërbimi i edukimit special në Kosovë.
- Bujari, Remzi “Mundësitë dhe parakushtet e përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në sistemin e rregullt mësimor”, “Dija”, RHRDP, nr. 3, Prishtinë, 2003.
- Bejtullahu, prof. Emrush, Defektolog logoped (2007) “Njohuri mbi aftësinë e kufizuar dhe rehabilitimi” Prishtinë.
- Brestovci, Behlul (1988), “Belbëzimi, të folurit inteligjenca antropometria motorika anksioziteti” LSHDKSAK, Prishtinë.
- Brestovci, Dr. Behlul, “Qasje bashkëkohore në edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta” Prishtinë.
- “Broshura e gjuhës së shenjave “(2002), SHSHK, “Iliri”, Prishtinë.
- Hajmers, Vilhelm (1986), Edukimi i fëmijës së verbër (Èie Erziehe ich mein blindes kind), ETMM, Prishtinë.
- “Koncepti evropian për mundësinë e qasjes (përshtatshmërisë së lëvizjes)” 2002, “Art Mouse”, Prishtinë.
- “Korniza e politikës përmbledhëse mbi çështjen e aftësisë së kufizuar në Kosovë” (2001).
- “Korniza e Kurikut të ri të Kosovës” (2001), Prishtinë.
- Miller, Bonnie (2005), “Komunikimi me fëmijë”, Doracak për prindër e arsimtarë, “QPEA”, Ferizaj.
- Miller, Bonnie (2005), :Si të krijohet kontakti i suksesshëm me nxënësit”, Doracak për arsimtarë, “QPEA”, Ferizaj.
- Muliqi, Prof. Def. Shefqet, “Tiflogjia, Edukimi dhe arsimimi i fëmijëve me dëmtime në të parë”, UP, FF, DPS, Prishtinë.
- Nano, prof. as. dr. Virxhil, “ Personat me aftësi të kufizuara mendore dhe përgatitja e tyre për punë”, “Revista pedagogjike”, nr.4, 2007, fq. 3.
- Nano, Virxhil “ Familja, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe përgatitja e tyre për jetë”, “Sfida”, FSHDP, Tiranë, 2001, nr.6, fq.6.
- Nano, prof. as. dr. Virxhil, “ Mbi integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e zakonshme të Italisë”, “Revista pedagogjike”, nr.2, 2001, fq. 119.
- Pettijohn, F. Terry (1996), “Psikologjia, Një hyrje koncize” (bot. i II), “Lilo”, Tiranë.
- Saqellari, Spiro (2009), “Përballë fëmijës me probleme të foluri”, “Onufri”, Tiranë.
- “Të drejtat e tona (mendime të fëmijëve për të drejtat e tyre)”, 2007, QDFP, br. 17, Prishtinë.
- “Të drejtat e fëmijëve (në perspektivë)”, 2007, nr.20, QDFP, Prishtinë.
- ’Të gjithë jemi inteligjentë- Shmangia e diskriminimit intelektual te fëmijët” (2003), CDE, Tiranë, fq. 57-58.
- “Të nxënëtit në bashkëpunim “(2001), udhëzues nr. 5, KEC, Prishtinë.
- Vasconi, Marcella (2004), “Psikologjia, historia, metodat, objektivat” “Botimet toena”, Tiranë.
- Zabeli, Mr. Sc. Naser (2003), “Edukimi inkluziv – Teori dhe praktikë aktuale”, Prishtinë.
- Zabeli, Naser (2001) “Nxënësit me nevoja të veçanta”, KEC, Prishtinë.